

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 8, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 11, në lidhje me nenin 80 paragrafi (4) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14), Ligjit për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.24/03, 13/05, 14/07, 55/07 dhe 17/11), Rregulloren për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.42/03, 8/09, 12/09 dhe 175/11) dhe Rregulloren për planin kontabël dhe bilansin e organizatave jofitimprurëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 117/05 dhe 11/06), në pajtim me nenin 15 paragrafi (1) nënparagrafi 7 të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.01-4351/1 datë 29.08.2014 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr.02-6126/2 datë 12.12.2014, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 21-të mbajtur më 12.12.2014, miratoi:

## **RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E PUNËS FINANCIARE DHE KONTABËL TË AGJENCISË PËR SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

### **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHËME**

Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për punën financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, menaxhimin e kontabilitetit, librat zyrtarë, dokumentet e nevojshme për përpunimin e të dhënave, njohjen me të ardhurat dhe shpenzimet, inventarin e mjeteve, llogaritjen, faturimin dhe inkasimin e tarifës vjetore të lejes për emetimit në televizion ose radio, për tarifën vjetore për mbikëqyrjen e kryer për ritransmetim të shërbimeve programore ose me ofrimin e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, dhe pyetje të tjera lidhur me punën financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

### **II. MËNYRA E MENAXHIMIT TË KONTABILITETIT**

#### **Neni 2**

Kontabiliteti në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele menaxhohet në mënyrë që ofron saktësinë, gjithëpërfshirjen, në kohë, të përditësuarra dhe paraqitje individuale të pozicioneve të bilancit, gjendjen e mjeteve, burimet e mjeteve, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatet e punës në pajtim me Rregulloren për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.24/03, 42/03, 8/09, 12/09 dhe 175/11) dhe Rregulloren për planin e kontabilitetit dhe bilansin e organizatave jofitimprurëse („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 117/05 dhe 11/06).

### **III LIBRAT ZYRTARË, DOKUMENTET E KONTABILITETIT DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE**

#### **Neni 3**

kontabilisti në Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele udhëhiqet librat zyrtar për vitin e punës që është e barabartë(njëjtë) me vitin kalendarik.

librat zyrtar udhëhiqen në gjuhën maqedonase me shifra arabe dhe vlerat e shprehura në denarë.

#### **Neni 4**

Librat zyrtar të kontabilitetit në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele janë: ditari, libri kryesor dhe librat ndihmës (libër për arkë(kasafortë), libër për llogari hyrëse, libër për llogari dalëse dhe libër për furnizime) .

Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave për ndyshimet e paraqitura, përkatësisht transaksioneve, kryhet me ndihmën e llogaritësit elektronik ose mekanikisht duke respektuar parimin e udhëheqjes(menaxhimit) të duhur.

#### **Neni 5**

Regjistrimi i të dhënave në librat zyrtar duhet të kryhet mbi baza të dokumenteve kontabël të vërteta dhe të rregullta.

Dokumenti i kontabilitetit është dëshmi me shkrim për ndryshimin e kryer, përkatësisht për transaksionin e kryer.

Dokumenti i kontabilitetit shërben si bazë për regjistrimin e të dhënave në librin zyrtar, dhe në të njëjtën kohë dhe si bazë për kontrollim dhe revizion të punës.

Udhëheqësi i Sektorit kompetent për kryerjen e punëve ekonomiko-finansiare të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele është përgjegjës për përpilimin e dokumenteve të kontabilitetit, ndërsa drejtori i Agjencisë ose zëvendës drejtori, me nënshkrimin e tij garanton që dokumenti është i vërtetë dhe realisht e tregon ndryshimin e krye, pra transaksionin.

### **IV PRANIMI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

#### **Neni 6**

Pranimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele zbatohet sipas parimit të modifikuar të shfaqjes së ndryshimeve të pjesëshme dhe transaksioneve në mënyrë të përcaktuar nga neni 13 të Ligjit për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse dhe neni 18 të Rregullores për kontabilitet për orgnizatrat jofitimprurëse.

## **Neni 7**

Pranimi i të ardhurave kryhet në bazë të respektimit të parimit të rritjes së modifikuar.

Në kontabilitet pranohen vetëm të ardhurat që janë realizuar (paguar), deri më 31 dhjetor të vitit aktual, ose janë realizuar në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i periudhës kontabël të cilës i referohen, përkatësisht jo më vonë se 31 janari i vitit pasardhës, nga ajo periudhë e llogaritur.

## **Neni 8**

Gjatë përcaktimit të shpenzimeve zbatohet dukuria e modifikuar, përkatësisht pranohen shpenzimet e paguara deri më 31 dhjetor të vitit aktual, ose në afat prej 30 ditësh nga përfundimi i periudhës kontabël përkatësisht deri më 31 janar të vitit pasardhës, me kusht shpenzimet t'i referohen periudhës së specifikuar të llogaritjese.

## **Neni 9**

Përlllogaritja e tatimeve kryhet në bazë të bazave tatimore të përcaktuara në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të cilat janë të vlefshme në Republikën e Maqedonisë.

## **V VLERËSIMI I POZICIONEVE TË BILANSIT RIVALORIZIMI DHE INVENTARI(REGJISTRIMI)**

### **Neni 10**

Mjetet afatgjate dhe afatshkurtër tregohen me vlerën e blerjes. Vlera e blerjes për mjetet afatshkurtër përbën çmimin e blerjes së rritur për import, tatimet që janë të pakthyeshme dhe të gjitha shpenzimet e tjera që direkt mund t'i shtohen vlerës së blerjes, përkatësisht shpenzime për furnizime.

Mjetet materiale afatgjate përfshijnë objektet ndërtimore, pajisjet dhe mjetet e tjera materiale, elektronike, veglat elektrike dhe mekanike, makina shkrimi, makina llogaritëse (kalkulator), përfshir dhe instrumente muzikore, mobiljet dhe mjete transporti si dhe mjete të tjera.

Baza për përshkrimin e mjeteve afatgjate është blerja, përkatësisht vlera e revallorizuar e mjeteve afatgjate.

Baza e vlerës së mjeteve materiale afatgjate zbatohet me metodën vijëdrejtë të fshirjes(përzgjedhjes) duke zbatuar normat vjetore të përcaktuara në Rregulloren për kontabilitet për organizatat jofitimprurëse.

### **Neni 11**

Mjetet finansiare në arkë dhe në llogarinë valutore të brendshme barten në librin kryesor në shumë nominale sipas çertifikatave të dorëzuara për ato llogari, ndërsa mjetet valutore në llogaritë e bankave zyrtare dhe në arkën valutore ku valutat e huaja janë të shprehur në denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e balancimit.

## **Neni 12**

Detyrat e punonjësve në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me paradhënie (denarë dhe valutë) kryhen në bazë të aktvendimit të miratuar dhe fletudhëtim.

Disbursimi i paradhënieve për fletudhëtimet për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit kryhet në afat prej 5 (pesë) ditë pune nga dita e kthimit nga udhëtimi.

Çdo punonjës gjatë realizimit të udhëtimit zyrtar të kryer me transport ajror(aeroplan) në ngarkesë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, gjatë risbursimit të fletudhëtimit duhet të bashkëngjis dhe kartën e imbarkimit(udhëtimit) si dëshmi se udhëtimi është realizuar.

## **Neni 13**

Detyrimet e Agjencisë për furnitorët, punojnësit, detyrimet për roqën, taksat dhe kontributet shprehen në pajueshmëri me vlerën e tyre e cila është në dokumentin përkatës të kontabilitetit.

## **Neni 14**

Fshirja e kërkesave kryhet në bazë të parashkrimit të kërkesës, vendim gjyqësor i formës së prerë, kërkesë e papaguar nga subjektet në rast falimentimi ose likuidimi.

## **Neni 15**

Mjetet materiale afatgjate, vlera individuale e të cilave në moment e blerjes është më e ulët se 300 euro në kundërvlerë në denarë është klasifikuar si inventar i vogël(imët) i cili shlyhet një herë pavarësisht nga zhvleftësimi i përdorimit.

## **Neni 16**

Zhvleftësimi llogaritet individualisht për çdo mjet sipas shkallës së përcaktuar me Rregulloren për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse për aq kohë sa nuk zhvleftësohet. Kur do të kompensohet e gjithë vlera e mjetit, ndalohet përllogatitja e mëtejshme e zhvleftësimit. Kjo vlen dhe nëse mjetet ende janë në përdorim.

## **Neni 17**

Mjetet materiale dhe jomateriale afatgjate rivlerësohen në mënyrën e përcaktuar nga Ministri i Financave

## **Neni 18**

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale të paktën një herë në vit detyrohet të harmonizojë gjendjen e mjeteve dhe burimet e tyre të përmendura në kontabilitet me gjendjen faktike që përcaktohet nga regjistrimi i kryer më 31 dhjetor, sipas mënyrës së përcaktuar nga Ministri i Financave.

## **Neni 19**

Në bazë të aktit të miratuar nga ana e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, formohet komision për regjistrim, përkatësisht përcaktohen anëtarët dhe zëvendës anëtarët, detyrat që duhet të kryejnë, kohën e fillimit të regjistrimit dhe afatin për dorëzimin e raportit për regjistrimin e përfunduar me listat e regjistrimit.

## **Neni 20**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale e miraton Raportin për regjistrimin e kryer me miratim-Vendim.

Raportin për regjistrimin e kryer me vendimin e Këshillit të Agjencisë për Raportin e miratuar, me qëllim për regjistrim të ndryshimeve dhe miratim të kontabilistit për gjendjen aktuale të përcaktuar në regjistrim, dorëzohet pranë Sektorit kompetent për kryerjen e punëve ekonomiko-finansiare më së voni njëzet ditë para afatit ligjor për dorëzim të llogarisë vjetore.

## **VI RAPORTET THEMELORE FINANCIARE**

### **Neni 21**

Agjencia për Shërbime mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin që kaloi më 31 dhjetor përpiloi raportin financiar, që përmban:

- Bilansin e gjendjes;
- Bilansin e të ardhurave dhe shpenzimet; - -  
Shënime mbi rezultatet e marra;
- Bilanci tatimor;
- Të dhëna të veçanta për evidencë shtesë të organizatave jofitimprurëse dhe
- Struktura e të ardhurave sipas veprimtarisë.

### **Neni 22**

Raportin financiar nga neni 21 i kësaj Rregulloreje e miraton Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

## **VII FAKTURIMI DHE INKASIMI I TAKSËS(TARIFËS) VJETORE PËR LEJE PËR EMETIM NË TELEVISION OSE RADIO DHE TË KOMPENSIMIT PËR MBIKËQYRJE TË OPERATORËVE QË RITRANSMETOJNË SHËRBIME PROGRAMORE OSE OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE**

### **Neni 23**

Kompensimi(tarifën) vjetor për lejen për emetim televiziv ose radio llogaritet për çdo vit aktual, me fillim nga data e dhënies së lejes.

Llogaritja e tarifës vjetore për lejen, e paraqitur në paragrafin (1) të këtij neni, kryhet në bazë të formës së përmbjtur në nenin 80 nga Ligji për Shërbime

Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të radiodifuzerëve („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 172/14) dhe Rregulloren për zonat që emetojn programe në televizion dhe radio („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 172/14).

Për kompensimin vjetor të përcaktuar do të punohet(krijohet) fakturë në pajtueshmëri me lejen e dhëna për emetim në televizion ose radio.

Në fakturë shënohet afati i pagesës, që parashihet 30 ditë nga dita e pranimit të faturës e dhënë nga Agjencia.

Fatura për pagesën e kompensimit(tarifës) vjetore për lejen e transmetimit në televizion ose radio, për çdo vit aktual jepet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e dhënies së vlefshmërisë së lejes për emetim në televizion ose radio.

## **Neni 24**

Nëse pas dorëzimit të faturës, poseduesi i lejes për emetim në televizion ose radio, nuk kryen pagesën e kompensimit (tarifës) së përlogaritur në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në pajtueshmëri me nenin 83, dhe në lidhje me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 6 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, (ngren) inicon procedurë për heqje të lejes për emetim në televizion ose radio propozuar nga drejtori i Agjencië.

Për procedurën e inicuar për heqjen e lejes, njoftohet dhe poseduesi i lejes me njoftim me shkrim.

Pas inicimit të procedurës për heqjen e lejes, Këshilli i Agjencisë është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit të drejtorit të Agjencisë, të sjellë vendim me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Nëse poseduesi i lejes për emetim në televizion ose radio në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit nga drejtori për heqjen e lejes ka kryer pagesën, procedura e inicuar për heqjen e lejes ndërpritet.

Nëse poseduesi i lejes për emetim në televizion ose radio nuk ka kryer pagesën e kompensimit (tarifës), pas dorëzimit të faturës në afatin e paraqitur në paragrafin (3) të këtij neni, e njëjta pëson ndalesë dhe do t'i lëshohet faturë e re, e cila i referohet vetëm periudhës që ka punuar, pra deri në ditën e miratimit të vendimit për heqjen e lejes. Fatura e lëshuar për periudhën e cekur, duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies së saj. Në të kundërtën pagesa e borxhit, do të kryhet nga gjykata, pra në mënyrë ligjore.

## **Neni 25**

Kompensim (tarifë) vjetor për mbikëqyrje e paguajnë operatorët që ritransmetojnë shërbime programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës.

Shuma e tarifës vjetore për mbikëqyrje nga paragrafi (1) i këtij neni llogaritet në bazë të nenit 142 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, dhe i njëjti arrin 0,596 të të ardhurave totale vjetore të operatorëve që ritransmetojnë shërbime programore ose të ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, të realizuar gjatë vitit të

kaluar kalendarik, ose pjese më të shkurtër gjatë vitit kur operatori që ritransmeton shërbime programore ose ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës fillon të ofrojë shërbim.

Operatorët që ritransmetojnë shërbime programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës janë të obliguar më së voni deri më 15 mars të vitit aktual drejtuar Agjencisë të dorëzojnë raport për shumën e të ardhurave totale.

Agjencioni, në bazë të raportit të dorëzuar, përgatit aktvendim për përcaktimin e detyrimit për pagesën e tarifës vjetore për mbikëqyrjen e paketave programore të ritransmetuara që ka kryer Agjencia dhe në bazë të aktvendimit lëshohet dhe fatura për kompensim vjetor për mbikëqyrjen.

Operatorët që ritransmetojnë shërbime programore ose ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, faturën për kompensim vjetor për mbikëqyrje janë të obliguar ta paguajnë në afat deri më 15 prill të vitit aktual në llogari të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Nëse pagesa për kompensim nuk kryhet në afat të caktuar, pra më së voni deri më 15 prill të vitit aktual, pagesa për kompensim vjetor do të kryhet nga gjykata pra në mënyrë ligjore.

Nëse në Agjencion ekziston dyshimi bazë për vërtetësinë e realizimit të të ardhurave vjetore bruto, ka të drejtën në shpenzimet e operatorit që ritransmeton shërbime programore ose ofruesit të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës të kryej vlerësim dhe një herë nga ana e revizorit të jashtëm. Në rast se të ardhurat totale të vlerësuar devijojnë nga totali i raportuar, gjatë llogaritjes së kompensimit (tarifës) vjetore, Agjencia do të detyron operatorin që ritransmeton shërbime programore ose ofruesin e shërbimit mediatik audiovizuel sipas kërkesës për të paguar shumën e llogaritur.

## **VIII PLANI FINANCIAR VJETOR**

### **Neni 26**

Plani financiar vjetor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale përmban të dhëna për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë për vitin e ardhshëm (vijues) të grupuara sipas strukturës organizative të Agjencisë, si dhe investimet kapitale të planifikuara për vitin e ardhshëm (vijues).

Këshilli i Agjencisë me propozim të drejtorit të Agjencisë sjell vendim për miratimin e Planit Vjetor Financiar për çdo vit aktual.

Gjatë vitit mund të kryhet ndryshim në planin financiar vjetor (konvertim i mjeteve të planifikuara, rritjen e mjeteve të planifikuara) sipas normave të shpenzimit, nëse kemi të bëjmë me shpenzime që nuk mund të parashikoheshin. Për të gjitha ndryshimet e bëra duhet të ekzistojë arsyetim me shkrim.

Vendim për ndryshim të planit financiar miraton Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuel, me propozim të drejtorit të Agjencisë.

## **IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 27**

Me miratimin e kësaj Rregulloreje përfundon së vlefshmi Rregullorja për procedurën e punës financiare dhe të kontabilitetit të Këshillit për radiodifuzion të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.64/2012).

### **Neni 28**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën në vijim nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale

**Nr. 01-6222/1  
12.12.2014  
Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetar i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**